



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

VENDIM
Nr. 41, Datë 09.12. 2015

PËR MIRATIMIN E PROCESIT TË MIRATIMIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIMIN
E FURNIZIMIT ME UJË, LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA

Në zbatim të nenit 14, dhe nenit 22, pika 1, të ligjit numër 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe në plotësim të vendimit të KKRR, Nr. 39 datë 09.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

Të miratojë procesin e miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, e detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë operatorët që kryejnë këto shërbime, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Avni Dervishi

PROCESI I MIRATIMIT TË TARIFAVE

1. Procedura e aplikimit fillon me paraqitjen e kërkesës nga operatori për ndryshimin e tarifave.
2. Kërkesa për ndryshim të tarifës, e paraqitur nga operatori, bazohet në analizën tekniko ekonomike (apo planin e biznesit) për shkaqet e ndryshimit të tarifave për shërbimet që ai ofron.
3. Përpara paraqitjes së aplikimit për ndryshimin e tarifave pranë Entit Rregullator, operatori bazuar në këtë analizë (plan biznesi), i paraqet kërkesën për miratimin e ndryshimit të tarifave organeve drejtuese të shoqërisë, pronarit si dhe organizon seancën dëgjimore me publikun (bazuar në udhëzimin përkatës).
4. Në situata të jashtëzakonshme (siç mund të jetë rritja e çmimeve, inflacioni) që ndikojnë në mënyrë të atillë duke rritur koston totale me më shumë se 15% dhe në kushtet kur operatori duhet ti mbulojë vetë këto kosto, operatori duhet ti kërkojë ERRU rillogaritje dhe përshtatje të tarifës.
5. ERRU, kur e gjykon të arsyeshme, mund t'i sugjerojë një operatori të aplikojë për ndryshimin e tarifave.
6. Skema e përgjithshme e procesit të miratimit të tarifave ku përcaktohen hapat bazë që do të ndiqen gjatë këtij procesi është bashkëlidhur në Aneksin 1 të kësaj procedure.
7. Në mënyrë të detajuar në Aneksin 2 bashkëlidhur gjendet skema e procesit të aplikimit për tarifa të reja, ku janë përcaktuar qartë hapat dhe aktorët e përfshirë në këtë proces.


ANEKSI 1

Skema e përgjithshme e procesit të miratimit të tarifave




ANEKSI 2

Skema e detajuar e procesit të miratimit të tarifave



PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES

Aplikimi nje ose shumejcar



PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES

Aplikimi nje ose shumevjecar

FAZA III

65 dite pune

50 dite pune

10 dite pune

5 dite pune

ERRU ndermerr analizen e Indikatoreve dhe te tarifes

Departamenti Ekonomik Pergatit Informacionin


Departamenti Teknik pergatit Informacionin

Departamenti Ekonomik pergatit Informacionin final per Komisionin

Komisioni shqyrton informacionin dhe mer nje vendim

PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES

Aplikimi nje ose shumejekar



PROCESI I APLIKIMIT TE TARIFES

Aplikimi nje ose shumevjecar

FAZA VI

10 dite pune

